




# **Ekonomia e hapur dhe Financat Ndërkombetare**

**Profesori i lëndës:  
Alban F. HETEMI, PhD.C**

# Ekonomitë e hapura

- Një ekonomi e hapur është ajo ekonomi që ndërvepron lirisht me ekonomitë e tjera në mbarë botën.



# Variablat kryesore makroekonomike në një ekonomi të hapur

- Variabla të rëndësishëm makroekonomikë të një ekonomi të hapur përfshijnë:
  - Eksportin neto
  - Investimet e jashtme neto
  - Norma nominale e këmbimit valutor
  - Norma reale e këmbimit valutor

# Supozimet themelore të një Modeli makroekonomik të një ekonomie të hapur

- Modeli merr GDP e ekonomisë si të dhënë.
- Modeli merr nivelin e çmimeve të një ekonomie si të dhënë.

# OFERTA DHE KËRKESA PËR FONDET KREDITORE DHE KËMBIMI VALUTOR

- Tregu për fondet kreditore

$$S = I + NCO$$

- Në normën ekuilibër të interesit, shuma që njerëzit dëshirojnë të kursejnë saktësisht është e balancuar me investimet dhe neto rrjedhën e kapitalit.


# Tregu për fondet kreditore

- Oferta për fonde kreditore vie nga kursimet nacionale (S).
- Kërkesa për fonde kreditore vie nga investimet e brendshme ( $I$ ) dhe neto rrjedhat e kapitalit (ang. *Net Capital Outflows* –  $NCO$ ).

# Tregu për fondet kreditore

- Oferta dhe kërkesa për fonde varet nga norma reale e interesit.
- Një normë e lartë reale e interesit inkurajon njerëzit të kursejnë më shumë dhe në këtë mënyrë të rrisin sasinë e fondeve të ofruara kreditore.
- Norma e interesit përshtatet për të sjellë ofertën dhe kërkesën për fonde kreditore në ekuilibër.

# Figura 1 Tregu për fondet kreditore





# Tregu për fondet kreditore

- Në normën e interesit në ekuilibër, shuma që njerëzit dëshirojnë të kursejnë saktësisht balancon investimet e brendshme dhe neto investimet e jashtshme.

# Tregu i këmbimit të valutës së huaj

- Dy anë të tregut të këmbimit të valutës së huaj janë prezentuar nga *NCO* dhe *NX*.
- *NCO* përfaqëson çekeulibrin në mes të shitjeve dhe blerjes së aseteve kapitale
- *NX* përfaqëson çekeulibrin në mes të eksporteve dhe importeve të mallrave dhe shërbimeve.

# Tregu i këmbimit të valutës së huaj

- Në tregun për valutë të huaj EUR tregtohet për shitblerjen e valutave të huaja.
- Për një ekonomi të hapur, si tërësi,  $NCO$  dhe  $NX$  duhet të balancohen me njëra tjetrën:


$$NCO = NX$$

Çmimi që balancon ofertën dhe kërkesën për valutë të huaj është norma reale e këmbimit valutator.

# Tregu i këmbimit të valutës së huaj

- Kurba e kërkesës për valutë të huaj është me pjerrtësi rënëse sepse një normë e lartë e këmbimit valutator i bënë mallrat e vendit më të shtrenjta për konsumatorët e huaj.
- Kurba e ofertës është vertikale sepse sasia e ofruar e eurove për neto rrjedhën e kapitalit nuk është e lidhur me normën reale të këmbimit valutator (kur flasim për tregun valutator këtë e marrim si të dhënë).

## Figura 2 Tregu i këmbimit të valutës së huaj



# Tregu i këmbimit të valutës së huaj

- Norma reale e këmbimit valutor përshtatet për të balancuar ofertën dhe kërkesën për euro.
- Në normën reale të këmbimit –në ekuilibër- kërkesa për euro për eksportet neto saktësisht balancon ofertën e eurove që duhet këmbyer në valutë të huaj për të blerë asete jashtë vendit.

# EKUILIBRI NË EKONOMI TË HAPUR


- Në tregun e fondeve kreditore, oferta vie prej kursimeve nacionale dhe kërkesa vie prej investimeve të brendshme dhe neto rrjedhës së kapitalit.
- Në tregun e këmbimit të valutave të huaja, oferta vie prej neto rrjedhës së kapitalit dhe kërkesa vie prej neto eksporteve.

# EKUILIBRI NË EKONOMI TË HAPUR

- Neto rrjedha e kapitalit lidhet me tregun e fondeve kreditore dhe tregun e këmbimit të valutave të huaja.
  - Determinantja kryesore e neto rrjedhës së kapitalit është norma reale e interesit.



# Figura 3 Si neto rrjedha e kapitalit varet nga norma e interesit?




# EKUILIBRI NË NJË EKONOMI TË HAPUR



- Çmimet në tregun e fondeve kreditore dhe në tregun e këmbimit të valutave të huaja përshtaten përnjëherë për të balancuar kërkesën dhe ofertën në këto dy tregje.
- Kjo bëhet në atë mënyrë që determinon variablat makroekonomikë si kursimet nacionale, investimet e brendshme, investimet e huaja neto dhe eksportet neto.

# Figura 4 Ekuilibri në një Ekonomi të hapur

(a) Tregu i fondeve kreditore



(b) Neto rrjedha e kapitalit



(c) Tregu i këmbimit të valutave të huaja


# SI POLITIKAT DHE NDODHITË KANË EFEKT NË NJË EKONOMI TË HAPUR ?

- Magnituda dhe variacioni në variablat makroekonomike varet nga faktorët si në vijim:
  - Deficiti Buxhetor Qeveritar
  - Politikat Tregtare
  - Stabiliteti politik dhe ekonomik

# Deficiti buxhetor

- Në një ekonomi të hapur, deficiti buxhetor...
  - redukton ofertën për fonde kreditore,
  - rrit normën e interesit,
  - redukton investimet e brendshme,
  - shkakton uljen e neto investimeve të huaja.

# Figura 5 Efektet e Deficitit Buxhetor Qeveritar



# Deficiti buxhetor

- Efektet e deficitit buxhetor në tregun e fondeve kreditore
  - Një deficit buxhetor redukton kursimet nacionale, të cilat . . .
    - zhvendosin në të majtë kurbën e ofertës për fonde kreditore, e cila . . .
    - rrit normën e interesit.

# Deficiti buxhetor

- Efektet e Deficitit Buxhetor në neto investimet e huaja
  - Norma më e lartë e interesit redukton neto investimet e huaja.



# Deficiti buxhetor

- Efektet në tregun e këmbimit të valutave të huaja
  - Një zvogëlim në neto investimet e huaja redukton ofertën për euro, e cila duhet këmbyer në valuta të huaja.
  - Kjo shkakton rivlerësim të normës reale të këmbimit valutator dhe kjo shkakton deficitin tregtar.
  - Deficitet binjakë

# Politika tregtare

- Një *politikë tregtare* është ajo politikë qeveritare që direkt ndikon në sasinë e mallrave dhe shërbimeve që një vend importon ose eksporton.
  - Tarifa: Një taksë në mallrat e importuara.
  - Kuotë në import: Një limit në sasi në një mall të prodhuar jashtë dhe të shitur brenda vendit.

# Politika tregtare: Mbrojtja e proteksionizmit dhe kundërshtimi i tregtisë së lirë

- Mbrojtja e degëve foshnjore
- Kundërshtimi ndaj politikave të dumpingut dhe subvencioneve që ndjekin vendet e tjera
- Kuotat
- Tarifat

# Politika tregtare

- Për shkak se ato politika nuk ndryshojnë kursimet nacionale ose investimet e brendshme, politikat tregtare nuk ndikojnë në bilancin tregtar.
  - Për një nivel të caktuar të kursimit kombëtar dhe investimeve të brendshme, kursi real i këmbimit përshtatet për të mbajtur bilancin tregtar të njëjtë.
- Politikat tregtare kanë një efekt më të madh në tregjet mikroekonomike se sa në ato makroekonomike.

# Politika tregtare

- Efekti i një kuote në import
  - Për shkak se të huajt kanë nevojë për euro për të blerë mallra të BE, kjo rrit kërkesën për euro në tregun e këmbimit valutor.
    - Kjo çon në një rivlerësim të kursit real të këmbimit.

# Politika tregtare


- Efekti i një kuote në import
  - Nuk ka asnjë ndryshim në normën e interesit për shkak se asgjë nuk ka ndodh në tregun e fondeve huazueshme (kreditore).
  - Nuk ka ndonjë ndryshim në eksportet neto.
  - Nuk ka ndonjë ndryshim në neto investimet e huaja edhe pse një kuotë në import redukton importet.

# Politika tregtare



- Efekti i një kuote në import
  - Një rivlerësim i euros në tregun e këmbimeve valutore inkurajon importet dhe dekurajon eksportet.
  - Kjo kompenson rritjen fillestare në eksportet neto për shkak të kuotave të importit.

# Figura 6 Efektet e një kuote në import

(a) Tregu i fondeve kreditore



(b) Neto rrjedha e kapitalit



2. . . . dhe shkakton rivlerësimin e normës reale të këmbimit.

(c) Tregu i këmbimit valutor



# Politika tregtare

- Efektet e një kuote në import
  - Politikat tregtare nuk kanë efekt në balancën tregtare.


# Jostabiliteti politik dhe “fluturimi” i kapitalit

- “*Fluturimi i kapitalit*” është një reduktim i madh në kërkesën për asete të alokuara në një vend.

# Jostabiliteti politik dhe “fluturimi” i kapitalit

- “Fluturimi i kapitalit” ka impakt të madh në vendin prej të cilit kapitali transferohet, por kjo ndikon edhe tek vendet e tjera.
- Nëse investitorët shqetësohen për sigurinë e investimeve të tyre, kapitali shpejt mund të lë atë ekonomi.
- Norma e interesit rritet dhe valuta e vendit zhvlerësohet.

# Figura 7 Efektet e “fluturimit” të kapitalit



# Përmbledhje

---

- Për të analizuar ekonomitë e hapura dy tregje janë qendrore—tregu i fondeve kreditore/të huazueshme dhe tregu i këmbimit valutor.
- Në tregun e fondeve kreditore, norma e interesit përshtatet për të balancuar ofertën për fonde kreditore (nga kursimet nacionale) si dhe kërkesën për fonde kreditore (nga investimet e brendshme si dhe neto rrjedha e kapitalit).

# Përmbledhje

---

- Në tregun e këmbimit valutor të valutave të huaja, norma reale e këmbimit përshtatet për të balancuar ofertën e eurove (për neto rrjedhën e kapitalit) dhe kërkesa për euro ( për eksportet neto).
- Neto rrjedha e kapitalit është variabël që lidh këto dy tregje.

# Përmbledhje

---

- Një politikë që redukton kursimin kombëtar, të tilla si një deficit buxhetor i qeverisë, redukton ofertën e fondeve të huazueshme dhe rrit normën e interesit.
- Një normë e interesit më e lartë redukton neto rrjedhën e kapitalit, redukton ofertën e eurove.
- Euroja rivlerësohet dhe neto eksportet bien.

# Përmbledhje

---

- Kur investitorët ndryshojnë qëndrimet e tyre në lidhje me mbajtjen e aseteve të një vendi, shtrirja për ekonominë e vendit mund të jetë e thellë.
- Jostabiliteti politik në një vend mund të shkaktojë “fluturimin” e kapitalit jashtë vendit.
- “Fluturimi” i kapitalit ka tendencë të rrit normën e interesit dhe në këtë mënyrë shkakton zhvlerësimin e valutës së vendit.





**JU FALEMINDERIT !**

